



**KËRKESË PËR SHPREHJE INTERESI PËR POZICIONIN
“PIKË KOMBËTARE E KONTAKTIT PËR PROGRAMIN “HORIZON
EUROPE”**

Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit, në kuadër të zbatimit të marrëveshjes ndërkombëtare ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian për pjesëmarrjen e Republikës së Shqipërisë në programin e Bashkimit Evropian Horizon Europe – Programi Kuadër për Kërkimin dhe Inovacionin, shpall kërkesën për shprehje interesi për pozicionin “Pikë Kombëtare e Kontaktit për Programin Horizon Europe”

Të interesuarit për të vepruar si PKK për programin Horizon Europe duhet të dërgojë përmes postës në Agjencinë Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit (AKKSHI), dokumentet si vijon:

1. **Shprehje interesi shoqëruar me një letër motivimi për të vepruar si PKK për programin Horizon Europe,**
2. **Jetëshkrimin e tij/saj sipas formatit Europass (në english),**
3. **Dokumente mbështetëse që provojnë veprimtarinë e tij/saj kërkimore-shkencore,**
4. **Letër mbështetëse nga punëdhënësi – sipas shtojcës 3 bashkëlidhur – që e lejon kandidatin të veprojë si PKK për programin Horizon Europe në kuadër të punësimit të tij në institucionin punëdhënës.**

Afati i dorëzimit të dokumentacionit të mësipërm është 15 Prill 2024.

Kuadri ligjor

Bazuar në Ligjin Nr. 47/2022, “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërkombëtare ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian për pjesëmarrjen e Republikës së Shqipërisë në programin e Bashkimit Evropian Horizont Evropa – Programi Kuadër për Kërkimin dhe Inovacionin, Shqipëria merr pjesë si një vend i asociuar dhe kontribuon në të gjitha pjesët e Programit Horizont Evropa – Programit Kuadër për Kërkimin dhe Inovacionin, kjo referuar nenit 4 të Rregullores (BE) 2021/695 dhe zbatuar përmes programin specifik të krijuar me anë të vendimit (BE) 2021/7644.

Pikat Kombëtare të Kontaktit (PKK)

Një nga mekanizmat që bën të mundur një pjesëmarrje të sukseshme të institucioneve Shqiptare në Horizon Europe, është rrjeti i Pikave të Kontaktit (PKK). Rrjeti i PKK është struktura kryesore e vendosur në vendet anëtare të BE dhe vendet e asociuara që mundëson udhëzimin, ofrimin e informacionit praktik dhe ndihmën në të gjitha aspektet në pjesëmarrjen në programin Horizon Europe. Rrjeti drejtohet nga kordinatorët kombëtarë. Rrjeti i PKK-ve krijohet mbi bazë e kriterëve dhe përzgjedhjes nga Ministria përgjegjëse për kërkimin shkencor në vend. Rrjeti i PKK për programin HE i dërgohet autoriteteve përgjegjëse të Komisionit Evropian që i zyrtarizojnë ato duke i publikuar në Portalin Funding & Tenders.

Detyrat e PKK për Horizon Europe janë:

- a. të jetë i mirinformuar për objektivat, parimet dhe përmbajtjen e atij programi apo seksioni brenda Horizon Europe, për të cilën ai/ajo është emëruar si specialist i kësaj fushe në kuadër të rrjetit të PKK;
 - b. të marrë pjesë rregullisht në takimet vjetore – organizuar nga Komisioni Evropian - të rrjetit tematik ku PKK bën pjesë;
 - c. të krijojë marrëdhënie dypalëshe/shumëpalëshe me ENN (Rrjetin Evropian të Ndërmarrjeve), si një mundësi për t’i ofruar mbështetje reciproke, në përputhje me strukturat në nivel kombëtar;
 - d. të ketë një adresë elektronike (e-mail) të vlefshme për shkëmbim informacioni me kërkues të interesuar;
 - e. të marrë pjesë në mbledhjet e AKKSHI-t, si koordinatori kombëtar i rrjetit të PKK;
 - f. të përcjellë informacionin tek databaza e kërkuesve kombëtarë të fushës tematike për thirrjet e Horizon Europe;
 - g. të udhëhiqet nga parimet e transparencës dhe barazisë në ofrimin e informacionit lidhur me thirrjet për projektpropozime në kuadër të Horizon Europe;
 - h. të garantojë konfidencialitetin e kërkuar të informacionit;
 - i. të lehtësojë përpjekjet e IAL-ve për partneritete të mundshme me aktorë ndërkombëtarë për të lidhur dhe/apo krijuar konsorciume;
 - j. të ofrojë informim, këshillim e asistencë teknike për aplikimet e mundshme nga institucione kërkimore shkencore shqiptare në projekte që mbështeten nga Horizon 2020;
 - k. të mbajë kontakte me PKK-të e fushës së tij në vendet e tjera dhe të jetë i gatshëm të
-

marrë pjesë aktivisht në rrjete me karakter ndërkombëtar;

- l. të organizojë, në bashkëpunim me AKKSHI, aktivitete informuese e promovuese, në bashkëpunim me strukturat përkatëse të Komisionit Evropian, kur është e nevojshme, të tilla si ditë informative, konferenca, newsletters, panaire, etj;
 - m. të sigurojë informacion nga programe të tjera kërkim-zhvillimi të BE-së në fushën e kërkimit dhe inovacionit si Eureka, COST, etj. si dhe të vendosë lidhje me specialistët përkatës të shërbimeve mbështetëse;
 - n. të këshillojë të interesuarit mbi procedurat administrative, rregullat dhe çështje të ndryshme (p.sh. roli dhe përgjegjësia e një pjesëmarrësi në konsorcium, shpenzimet, të drejtat dhe detyrimet e pjesëmarrësit, rregullat e etikës dhe parimet e shkruara në “Rekomandimet e Komisionit Evropian C(2005)576 mbi Kartën Evropiane për Kërkuesit dhe Kodin e Sjelljes për rekrutimin e tyre);
 - o. të shpjegojë fushëveprimin dhe modalitetet e skemave të financimit që do të përdoren në thirrjet e Horizon Europe;
 - p. të këshillojë pjesëmarrësit, mbi menaxhimin e përshtatshëm dhe strukturat ligjore në projekte me buxhete të mëdha dhe/ose pjesëmarrës të shumtë;
 - q. të organizojë kurse dhe seminare trajnimi, kur është e nevojshme, për grupe specifike të synuara (SME, universitete, organizata të biznesit, etj.) ose për tema specifike (aspektet ligjore, kushtet e pjesëmarrjes, fushat kërkimore dhe novatore, rregullat financiare etj.);
 - r. lidhur me pjesëmarrjen në aktivitete të ndryshme brenda dhe jashtë vendit, te njoftoje AKKSHI-në për tematikën, qëllimin dhe agjendën, duke evidentuar qartë edhe detyrimet e AKKSHI-së, nëse parashikohen të tilla;
 - s. të raportojë te AKKSHI, jo më vonë se shtatë ditë pas zhvillimit të aktivitetit duke dërguar në formë elektronike një relacion të përmbledhur deri dy faqe (në format elektronik), i cili të përmbajë të dhënat mbi qëllimin dhe objektin e takimit, për ecurinë e bisedimeve, për rekomandimet përkatëse për çështjet e diskutuara si dhe sugjerimet për hapa të mëtejshëm për t’u ndërmarrë dhe planifikimin e punës për në vijim;
 - t. të raportojnë pranë AKKSHI-së brenda datës 30 qershor dhe 31 dhjetor të çdo viti mbi pjesëmarrjen në takimet e Horizon Europe sipas fushës tematike të kërkimit shkencor që përfaqësojnë, korrespondencën elektronike që kanë pasur me IAL-të apo kërkues të interesuar të marrin pjesë, projektpropozime të mundshme të paraqitura, aplikime projektesh të miratuara dhe gjithë punën e kryer si PKK Horizon Europe sipas treguesve të përcaktuar në shtojcën 5 bashkëlidhur, si dhe përcjellin propozimet përkatëse në kuadër të përmirësimit të pjesëmarrjes së Shqipërisë në programin Horizon Europe dhe rritjes së numrit të aplikimeve dhe përfituesve të projekteve.
-

SHTOJCA 1
FUSHAT TEMATIKE TË HORIZON EUROPE

1. Vështrim strategjik i zbatimit të programit, koherencës ndërmjet programeve individuale të punës të pjesëve të ndryshme të programit, duke përfshirë misionet;
2. Këshilli Evropian i Kërkimeve (ERC)
3. Marie Skłodowska-Curie Actions (MSCA)
4. Infrastrukturat kërkimore
5. Shëndeti
6. Kultura, kreativiteti dhe shoqëria gjithëpërfshirëse
7. Siguria Civile për Shoqërinë
8. Dixhitalizim, Industri dhe Hapësirë
9. Klima, Energjia dhe Lëvizshmëria
10. Ushqimi, Bioekonomia, Burimet Natyrore, Bujqësia dhe Mjedisi
11. Këshilli Evropian i Inovacionit (EIC) dhe ekosistemet Evropiane të Inovacionit
12. Zgjerimi i pjesëmarrjes dhe fuqizimi i Zonës Evropiane të Kërkimit

1. Strategic overview of the implementation of the whole programme, coherence across the individual work programmes of the different parts of the programme, including missions;
 2. European Research Council (ERC)
 3. Marie Skłodowska-Curie Actions (MSCA)
 4. Research Infrastructures
 5. Health
 6. Culture, creativity and Inclusive Society
 7. Civil Security for Society
 8. Digital, Industry and Space
 9. Climate, Energy and Mobility
 10. Food, Bioeconomy, Natural Resources, Agriculture and Environment
 11. The European Innovation Council (EIC) and European Innovation ecosystems
 12. Widening participation and strengthening the European Research Area
-

KRITERET PËR VLERËSIMIN E PIKAVE KOMBËTARE TË KONTAKTI (PKK)
SIPAS FUSHAVE TEMATIKE TË PROGRAMIT HORIZON EUROPE

- a. të pranojë me vullnet të lirë të kryejë rolin e PKK per programin Horizon Europe,
 - b. të ketë përvojë në fushën e kërkimit të Horizon Europe për të cilën kërkon të veprojë si PKK,
 - c. të ketë përvojë në projekte kërkimore kombëtare apo ndërkombëtare,
 - d. të ketë njohuri shumë të mira të gjuhës angleze,
 - e. të ketë aftësi të mira prezantimi dhe komunikimi,
 - f. të jetë i motivuar të kryejë punën si PKK e Horizon Europe,
 - g. të jetë i aftë të punojë në grup,
 - h. të jetë i disponueshëm dhe kontaktueshëm nëpërmjet email-it dhe telefonit gjatë orarit të punës, për të gjithë të interesuarit,
 - i. të jetë i disponueshëm për të marrë pjesë në takime kombëtare dhe ndërkombëtare në kuadër të detyrës që i ngarkohet,
 - j. të mos jetë në konflikt interesi në kryerjen e detyrës që i kërkohet,
 - k. të jetë i familjarizuar me objektivat, principet dhe përmbajtjen e programit pjesë e të cilit është caktuar.
-

LOGO
IAL / INSTITUCIONI

REKTORI / DREJTORI I PËRGJITHSHËM

Nr. _____ Prot.

Tiranë,
2024

më

LETËR MBËSHTETËSE

Nëpërmjet së cilës mbështet institucionalisht Z./Znj. _____, me detyrë _____ në institucionin _____, të veprjë si Pikë Kombëtare Kontakti (PKK National Contact Point NCP) në kuadër të programit Horizon Europe – Programi i BE-së për Kërkim dhe Inovacion.

(TITULLARI I INSTITUCIONIT)

AUTORIZIM PËR PUBLIKIMIN E TË DHËNAVE TË PIKËS SË KONTAKTIT

Unë i/e nënshkruari/a (emër atësia mbiemër), lindur më në me kartë identiteti/pasaportë nr., në rolin si Pikë Kombëtare e Kontaktit për Horizon Europe, autorizoj Ministrinë e Arsimit dhe Sportit dhe Agjencinë Kombëtare për Kërkimin Shkencor dhe Inovacionin, të publikojnë emrin tim dhe të dhënat e mia si më poshtë vijon, në faqet e tyre të internetit.

Jap gjithashtu miratimin tim që këto të dhëna të publikohen edhe në databazën on-line të Komisionit Evropian.

Emër Mbiemër

PKK në fushën tematike Horizon Europe

Institucioni punëdhënës

Adresa

Numër telefoni

Celular

E-mail

Nënshkrimi

TREGUESIT PËR VLERËSIMIN E PUNËS
SË PIKAVE KOMBËTARE TË KONTAKTIT HORIZON EUROPE

1. Numri i projekteve Horizon Europe të fituara në fushën përkatëse (krahasuar me periudhën e mëparshme),
 2. Numri i aplikimeve për projekte të përbashkëta me partnerë të huaj dhe vendas në Horizon Europe në fushën përkatëse (krahasuar me periudhën e mëparshme),
 3. Numri i konsorciumeve të krijuara ndërmjet institucioneve shqiptare dhe atyre të huaja në fushën përkatëse (krahasuar me periudhën e mëparshme),
 4. Numri i veprimtarive të organizuara në fushën përkatëse (si p.sh. ditë informative, seminare, konferenca, panairë, kurse, sesione trajnuese për H2020, emisione në media televizive dhe elektronike, faqe web të dedikuara) në bashkëpunim me AKKSHI dhe KE,
 5. Numri i emaileve që iu është përgjigjur nga aplikantët e interesuar për të marrë pjesë në projekte kërkimore shkencore Horizon Europe të fushës që mbulon,
 6. Numri i emaileve me të cilët ka shpërndarë dokumentacionin e përgjithshëm dhe specifik të Horizon Europe, përfshirë kushtet e pjesëmarrjes, mundësitë dhe kushtet për aplikimin, buxhetimin e projektit dhe raportimin,
 7. Numri i kërkuesve dhe organizatave, në veçanti aktorë të rinj dhe SME (Small and Medium Enterprises), që ka ndihmuar e mbështetur për të rritur pjesëmarrjen e tyre në Horizon Europe,
 8. Numri i partnerëve të huaj e kombëtarë që ka gjetur dhe ndërmjetësuar duke përdorur metodat e internetit, lidhjet e bashkëpunimit, shërbimet e partneritetit të rrjetit të ndërmarrjeve për SME etj.
-